



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

PROFILI I SEKTORIT TË INDUSTRIË SË PËRPUNIMIT DHE PAKETIMIT TË USHQIMIT







PROFILI I SEKTORIT
TË INDUSTRIË
SË PËRPUNIMIT
DHE PAKETIMIT
TË USHQIMIT

Mirënjohjet dhe Falenderimet

Ky raport është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës brenda kornizës së angazhimeve përmes projektit “Ndihmë Tregtisë”, implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Për realizimin e këtij raporti kontribut i veçant është dhënë nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

Kabineti i Ministrit

Departamenti i Industrisë

Departamenti i Integritimeve Evropiane dhe Koordinimit të Politikave

Agjencia për Mbështetje të Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë

Anketimi në terren realizuar nga TNS Index Kosova, Agjenci për hulumtime sociale, të mediave dhe marketingut

Kontrolli i Cilësisë:

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë

Njësia për Politika, Hulumtime, Çështje gjinore dhe komunikim

Njësia për Zhvillim Gjithpërfshirës

Projekti “Ndihmë Tregtisë”

Petrit Gashi, Phd – Konsulent i Jashtëm

Autore

Edona Kurtolli Alija

Përkthyes në gjuhën Shqipe:

Hyjnor Jasiqi

Dizajni: “XHAD Studio”, Prishtinë

Shtypi: “Grafika Rezniciq” Prishtinë

Si dhe një falenderim i veçantë për të gjithë respondentët e përfshirë në hulumtim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të pjesëmarrësve dhe të autorëve, dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë qëndrimet zyrtare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

E drejta autoriale © 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja

Mirënjohjet dhe Falenderimet.....	2
Lista e shkurtesave	4
1. Hyrje	5
2. Karakteristikat bazë të kompanive dhe industrisë	6
2.1. Madhësia dhe përbërja e sektorit	6
2.2. Shpërndarja rajonale, pronësia dhe struktura juridike e kompanive të industrisë	7
3. Kontributet dhe prodhimet në kompani/industri	10
3.1. Kontributet	10
3.2. Prodhimet	12
3.3. Shfrytëzimi i kapacitetit	13
4. Tregjet , eksportet dhe pengesat për eksport	15
5. Punësimi, kapacitetet njerëzore dhe zhvillimi i fuqisë punëtore në kompani/industri	20
5.1. Punonjësit në industri	20
5.2. Rritja e kompanive sipas numrit të punonjësve	21
5.3. Paga mesatare dhe niveli i arsimit të punonjësve	22
6. Investimet në kompani/industri dhe niveli teknologjik	24
7. Mjedisi i biznesit	26
7.1. Perceptimet për pengesat për zhvillimin e biznesit	26
8. Konkluzion	30
9. Referencat	31
Shtojcat	32
Shtojca 1: Informata për institucionet publike relevante.....	32
Shtojca 2: Shoqatat e biznesit të industrisë	33
Shtojca 3: Kodet e veprimtarisë.....	34
Shtojca 4: Kodet e SH.....	35

Lista e shkurtesave

CEFTA	Marrëveshja për Tregti të lirë në Evropën Qendrore
KE	Komisioni Evropian
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
GIZ	Deutsche Gesellschaft für International Zusammenarbeit GmbH
SH	Sistemi i Harmonizuar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
SDC	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim për Zhvillim
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID NOA	Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar, Mundësi të Reja në Bujqësi
BB	Banka Botërore

1. Hyrje

Ky profil i sektorit ofron informata për gjendjen aktuale të industrisë së agrobizneseve në Kosovë, me theks në veprimtaritë e përpunimit dhe paketimit të ushqimit. Raporti paraqet të dhëna makro si dhe në nivel të kompanive të grumbulluara përmes burimeve primare dhe sekondare, si dhe prezanton politikat dhe zhvillimet më të rëndësishme institucionale në këtë industri. Për më tepër, raporti gjithashtu përdorë statistika për ta përshkruar gjendjen aktuale.

Sipërfaqja tokësore e Kosovës është 1.1 milionë hektarë, nga të cilat 53% janë toka të punueshme. Rreth 60% të popullatës jetojnë në vise rurale dhe punojnë në bujqësi. Sektori i bujqësisë kontribuon me 13% të gjithsej BPV-së në Kosovë (Banka Botërore, 2011)¹, duke e bërë atë burim të rëndësishëm të të ardhurave. Produktet bujqësore gjithashtu përbëjnë 18% të eksporteve (MBPZHR, 2009). Megjithatë, përpunimi dhe paketimi i ushqimit është një nënsektor i vogël i bujqësisë dhe vetëm kohëve të fundit ka filluar të fitojë hapin. Nënsektorët kryesorë të kësaj industrie janë me fokus në perime, pemë, drithëra, bimë dekoruese dhe bimë mjekësore, vreshta, mish dhe qumështore (shih Shtojcën 1 për kodet e veprimtarive).

Për këtë profil, anketa e realizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) është nxjerrë nga të dhënat në nivel të kompanive nga baza e të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për vitin 2012,² ndërsa të dhënat e industrisë janë nxjerrë nga lista e kompanive të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK). Përveç kësaj, bilanci tregtar i sektorit është analizuar duke përdorur një bazë të të dhënave për periudhën 2010-2013, siguruar nga Doganat e Kosovës.

Sipas të dhënave të ATK-së, numri total i bizneseve aktive që veprojnë në këtë sektor ishte 812 kompani më 2013. Duke pasur parasysh se 65% e madhësisë së popullatës përbëhet nga biznese që veprojnë në prodhimin e bukës, brumërave të freskëta dhe ëmbëlsirave, mostra e kompanive të anketuara i ka lënë këto biznese jashtë për t'i ikur paragjyqimit. Mostra e përdorur për analizë në këtë raport përbëhej nga gjithsej 165 biznese nga një popullatë prej 283 kompani. Nga këto, 108 kompani ishin ndërmarrje mikro, të cilat punësonin më pak se 9 punonjës, ndërsa 57 janë kompani të mëdha.

1 http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2012/05/07/000406484_20120507085250/Rendered/PDF/668770IDA0R201001400MIGA0R201200024.pdf

2 Baza e të dhënave siguruar më 2013


2. Karakteristikat bazë të kompanive dhe industrisë

2.1. Madhësia dhe përbërja e sektorit

Industria e përpunimit dhe paketimit të ushqimit në Kosovë është e ndarë në nënsektorët vijues: perime dhe pemë, drithëra, dimë dekoruese dhe bimë mjekësore, vreshtaria, mishi dhe qumështoret.

Të dhënat nga ARBK (Figura 1) tregojnë se 1,200 kompani janë regjistruar në këtë sektor gjatë tri viteve të fundit, që përbën 7% të gjithsej kompanive të regjistruara në Kosovë. Megjithatë, duke pasur parasysh se bujqësia karakterizohet me shkallën më të lartë të informalitetit (Rinvest, 2009), numri aktual i kompanive që operojnë në sektor mund jetë edhe më i lartë. Veprimtaria e regjistruar më së shpeshti është prodhimi i bukës, brumërave të freskëta dhe ëmbëlsirave (68%).

Figura 1: Numri i kompanive të regjistruara 2010-2013




Burimi: ARBK, 2013

Për sa i përket bizneseve aktive, të dhënat nga ATK zbulojnë që më 2012, 816 kompani kanë qenë aktive në këtë sektor (Figura 2), nga të cilat 500+(61%) kanë vepruar në nënsektorin e prodhimit të bukës, brumërave të freskëta dhe ëmbëlsirave. Kompanitë që merren me përpunimin e drithërave dhe grurit zënë 20.1% të tregut, gjersa përpunimi i pemëve dhe perimeve përbën 15.4% të tregut. Kompanitë që janë


aktive në përpunimin e produkteve të qumështit, akullores dhe çokollatës përbëjnë gati 6% të tregut, gjersa të tjerat janë të përfshira në nënsektorë të tjerë.

Figura 2: Ndarja e bizneseve sipas veprimtarisë kryesore



Sektori i përpunimit dhe paketimit të ushqimit kryesisht përbëhet nga ndërmarjet mikro me më pak se 9 punonjës (65%), vijuar nga kompanitë e vogla (që punësojnë ndërmjet 10 dhe 49 punonjës) (24%), gjersa 10% të kompanive janë të mesme (të cilat kanë ndërmjet 50 dhe 259 punonjës) (Figura 3).

Figura 3: Ndarja e bizneseve sipas madhësisë




Burimi: ATK, 2013

2.2. Shpërndarja rajonale, pronësia dhe struktura juridike e kompanive të industrisë

Në Figurën 4, të dhënat nga ATK tregojnë se shumica e kompanive të përpunimit dhe paketimit të ushqimit janë të përqendruara në komunën e Prishtinës (33%), Prizrenit (16.5%) dhe Ferizajit (11.3%). Mitrovica, Lipjani, Podujeva, Gjakova dhe Peja, janë seli e rreth 7% të kompanive të përpunimit dhe paketimit të ushqimit, ndërsa 5.6% e tyre janë me vendndodhje në Gjilan.

Figura 4: Ndarja e bizneseve sipas rajonit



Burimi: ATK, 2013

Rezultatet e anketës tregojnë se 80% e bizneseve kanë deklaruar se janë të regjistruara si biznese individuale, 9% si ortakëri dhe 8% si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa një numër shumë i vogël i kompanive (më pak se 1%) janë të regjistruara si shoqëri aksionare apo kompani ndërkombëtare.

80% Të regjistruara si biznese individuale

Të dhënat tregojnë se moshë mesatare e pronarëve kryesor të kompanive të anketuara është 43 vjeç, që ndryshon nga 20 deri 72 vjeç. Rezultatet tregojnë se 44% të pronarëve të anketuar janë të moshës 39 deri 49 vjeç, gjersa 26% të tyre janë mbi moshën 50 vjeç. Pronarët të cilët janë 29 deri 39 vjeç administrojnë 20% të kompanive të anketuara. Sikurse që tregon Tabela 1, shumica e pronarëve i përket kategorisë së grupmoshës 39-49 vjeç.

94% e pronarëve të kompanive janë shqiptarë

Tabela 1: Ndarja e pronarëve sipas moshës

Moshë e pronarit	Përpjesa në %
18-28 vjeç	10%
29-39 vjeç	20%
39-49 vjeç	44%
> 50 vjeç	26%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rreth 94% e pronarëve të bizneseve janë shqiptarë, pak nën 3% janë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian (RAE), rreth 2% janë turq dhe boshnjakë, dhe pak nën 1% janë goranë, siç ilustron në Tabelën 2 me pikët specifike të përqindjes. Rezultatet e anketës tregojnë që 86% e pronarëve janë burra, që është indikacion i përfaqësimit të ulët të grave në këtë sektor.

Tabela 2: Ndarja e pronarëve të kompanive sipas përkatësisë etnike

Përkatësia etnike	Përpjesa në %
Shqiptarë	94%
RAE	3%
Turq	2%
Boshnjakë	2%
Goranë	1%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rubrika 1. Profili i një biznesi të suksesshëm që vepron në Kosovë

Me vendndodhje në afërsi të Gjilanit, në Kosovë, Ask Foods karakterizohet me një mjedis modern të punës dhe objekte dhe pajisje bashkëkohore. I themeluar në vitin 2008 si biznes familjar me 146 hektarë pemishte, është një nga kompanitë më të mëdha të përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë me mbi €3 milionë të investuara në makineri. Certifikuar me standarde të sigurisë së ushqimit ISO dhe HACCP, fabrika e prodhimit ka filluar me përpunimin e cilësisë më të lartë të pemëve dhe perimeve më 2008. Tani kompania ka rritur prodhimin e saj përmes lansimit të tri brendeve të reja (ASK, MAMS dhe ANNA) në kuadër të ombrellës ASK, dhe punëson mbi 400 punonjës gjatë sezonit të pikut që fillon në fund të gushtit/fillim të shtatori dhe zgjatë deri në fillim të nëntorit. ASK Foods ka 112 punëtorë të përhershëm dhe 80% të tyre janë gra. Ndonëse kapitali themeltar i kompanisë ishte privat (i pronarit) ASK Foods ka pranuar asistencë nga organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Kompania shfrytëzon pajisje më moderne për mbrojtjen e të korrave të saj nga breshëri dhe djegia nga dielli. Pemishtet e tyre kultivojnë molla, vishnje, kumbulla dhe mjedra. Me zgjerimin e kapaciteteve të prodhimit të kompanisë, ata është dashur të sigurojnë furnizime shtesë të cilat i blejnë nga bujqit lokalë.

Pronarët e ASK Foods kanë deklaruar se të qenit të suksesshëm ka qenë ëndërr e kamotshme e tyre, por që shohin vështirësi në mjedisin e biznesit në Kosovë, ku tatimi në inpute është çështja më problematike.

Risitë e aplikuara të ASK Foods mund të shihen në kombinimin e mirë të marketingut të tij. Duke arritur të ketë emër të besuar të brendit, të mbështetur me produkte cilësore Ask Foods ka arritur majën e tregut të Kosovës si kompania e parë e përpunimit e shkallës së madhe në këtë industri pas konfliktit.

Pozita e tregut, shumëllojshmëria e produkteve, dhe çmimet konkurruese janë përparësitë kryesore konkurruese të ASK Foods. Kompania i kushton vëmendje të posaçme ruajtjes së freskësisë dhe aplikimit të recetave tradicionale për t'i dhënë shije "shtëpiake" produkteve të saj. Produktet e saj përfshijnë marmelatë, reçel, kompotë frutash, lakër turshi, tranguj, kërpudha, panxhar, speca të djegës, salcë domatesh dhe ajvar tradicional. Ask Foods gjithashtu prodhon lëngje 100% natyrale nga disa fruta.

ASK Foods ka mbi 1.000 bujq lokalë të kontraktuar që punojnë drejtpërsëdrejti me kompaninë. Vendi i tyre i parë i eksportit ishte Kroacia, si dhe kanë eksportuar mbi 200 tonelata produkte në vendet e BE –së me zgjatjen e preferencave tregtare. Me një qarkullim vjetor prej rreth €2 milionë, ASK Foods gjithashtu eksporton produktet e saj në shtete të tjera duke përfshirë Zvicrën, Serbinë, Maqedoninë, dhe së shpejti janë duke planifikuar t'i shtrijnë eksportet në Austri dhe Britani të Madhe. Krahasuar me kompanitë tjera të përpunimit, Ask Foods ka investuar në marketing dhe në veçanti në promovimin e produkteve të tyre me anë të panairëve në Kosovë dhe jashtë vendit, reklamave televizive, afisheve, dhe llojeve të ndryshme të sponsorizimeve.

Produkti: Receta natyrale të freskëta e origjinale

Vendi: Supermarkete në pjesën e produkteve vendore në qytete më të mëdha

Çmimet: Dy nënbrende të arsyeshme e të përballueshme me synim grupe të ndryshme

Promovimi: Panairë vendore e ndërkombëtare, Anëtarësi në shoqata të shumta Reklama në TV, Pano reklamuese

Pas realizimit të rritjes prej 20% në të hyra vitin e kaluar, për t'i lehtësuar eksportet, kompania planifikon të hapë një zyrë përfaqësuese në Shqipëri dhe Mbretëri të Bashkuar.

Më 2012, Ask Foods është shpërblyer me çmimin Super Brand për rajonin, dhe gjithashtu është vlerësuar si Eksportuesi i Vitit më 2011 nga Shoqata e Eksportuesve të Kosovës (SHEK), si dhe me dizajnin më të mirë të eksportuesve për vitet e kaluara. Kompania ka arritur sukses në dominim në tregun vendor në një periudhë prej shtatë muajsh duke zënë pjesën më të madhe të kërkesës. Suksesi i tyre i ka dhënë shpresë prodhuesve të tjerë vendorë dhe kompanive të vogla të përpunimit, duke i inkurajuar ato që të angazhohen më shumë në përpunimin e pemëve dhe perimeve.

3. Kontributet dhe prodhimet në kompani/industri

3.1. Kontributet

Firmat e anketuara kanë deklaruar se kanë importuar 50% të lëndës së tyre të parë dhe mallrave të ndërmjetme, si materialet e paketimit, farërat, mish, si dhe përbërësit për përpunimin të perimeve dhe pemëve. Lënda e parë kryesisht është importuar nga Maqedonia, Serbia dhe Turqia. Shuma mesatare e lëndës së parë të importuar është vlerësuar të jetë afërsisht €64,000 për kompani, por shifrat ndryshojnë sipas madhësisë së kompanive. Kostoja mesatare e lëndës së parë për kompanitë mikro është rreth €23,000 në muaj, kompanitë e vogla dhe të mesme shpenzojnë mesatarisht mbi €50,000 në muaj, ndërsa kompanitë e mëdha shpenzojnë mbi €70,000 në muaj mesatarisht (Tabela 3). Të dhënat për kostot e kontributeve tregojnë se pjesa mesatare e lëndës së parë në shpenzimet e përgjithshme është 79%, ku kompanitë e mëdha shpenzojnë 37% të shpenzimeve të tyre të përgjithshme në lëndë të parë. Pagat përbëjnë rreth 7% të gjithë shpenzimeve mesatarisht, ndërsa shpenzimet tjera të mbetura janë 14%. Rreth 75% të të gjitha kompanive kanë deklaruar se shpenzojnë më pak se €100 në muaj për ujë, €300 për energji elektrike dhe €400 për shpenzime për derivate. Siç është pritur, ekziston një lidhje pozitive ndërmjet shpenzimeve për kontribute dhe madhësisë së bizneseve.

50% Të lëndës së parë importohet

Tabela 3: Shpenzimet mesatare mujore për kontribute sipas madhësisë së kompanive, në €

	Mikro (≤9 punonjës)	Të vogla (10-49 punonjës)	Të mesme (50-249 punonjës)	Të mëdha (>249 punonjës)
Lëndë e parë	23,911	51,725	53,681	74,821
Energji elektrike	320	1,977	5,625	10,000
Ujë	51	161	385	400
Derivate	401	3,164	3,246	6,564
Paga	250	1,750	6,250	10,000
Të tjera	403	2,629	950	1,000
Gjithsej	25,336	61,406	70,137	102,785

Burimi: Anketa e UNDP, 2013


Të dhënat e anketës tregojnë se kompanitë kanë burime të shumta të lëndës së parë dhe kontributeve. Rreth 37% të kompanive prodhojnë të gjitha apo disa prej lëndëve të tyre të para. Mbi 42% të kompanive e blejnë lëndën e tyre të parë nga kompanitë vendore, dhe 18% të kompanive importojnë lëndën e tyre të parë. Të dhënat e kategorizuara tregojnë se gjysma e kompanive të fundit importojnë ndërmjet 50% dhe 90% të lëndës së tyre të parë, gjersa gjysma tjetër importon nën 50% të saj.

Tabela 4: Furnizimi më lëndë të parë

Lënda e parë	Pjesëmarrja e kompanive
Prodhim vetjak	37%
Blerje në tregun vendor	42%
Import	18%
Import nga 50 deri 90%	9%
Import nën 50%	9%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Analizimi i shpenzimeve mujore të kontributeve sipas nënsektorëve të industrisë tregon se lënda e parë kontribuon më së shumti në shpenzimet mesatare mujore, veçanërisht për nënsektorët e përpunimit të verës, birrës dhe pijeve alkoolike (Figura 5).

Figura 5: Shpenzimet mujore për kontribute sipas veprimtarisë

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Të dhënat e anketës tregojnë se për disa nënsektorë, produkte të qumështit, akullore dhe çokollata dhe vajra, ujë dhe ujë mineral, pagat përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të shkaktuara, 48.2% dhe 21.2%, përkatësisht. Kompanitë në këta nënsektorë kanë raportuar se shpenzojnë më shumë për derivate: qumështoret, kompanitë e përpunimit të akulloreve dhe çokollatave (23.3%) dhe kompanitë e vajit, ujit dhe ujit mineral (44.4%). Për sa i përket shpenzimeve të ujit për tërë sektorin, kryesisht janë kompanitë e përpunimit të lëngjeve që e pësojnë pjesën më të lartë të shpenzimeve: përpunuesit e vajrave, ujit, ujit mineral (30% të shpenzimeve totale të kontributeve) dhe përpunuesit e verës, birrës dhe të tjerë (24.5% të shpenzimeve të përgjithshme për kontribute). Përpunuesit e vajit, ujit dhe ujit mineral, përsëri, kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve të energjisë elektrike, vijuar nga përpunuesit e pemëve dhe perimeve me 22.4%, dhe drithërave dhe grurit me pothuajse 20% të pjesës së këtyre shpenzimeve.

Tabela 5: Pjesa vjetore e shpenzimeve të kontributeve sipas veprimtarisë

	Lëndë e parë	Energji elektrike	Ujë	Derivate	Paga	Të tjera
Drithëra dhe grurë	16.5%	19.9%	3.6%	3.9%	0.7%	16.8%
Pemë dhe perime	12.0%	22.4%	4.6%	7.2%	0.4%	13.7%
Produkte të qumështit, akullore, çokollata	14.2%	7.0%	9.7%	23.3%	48.2%	22.9%
Biskota dhe bukë	4.0%	3.3%	2.9%	7.0%	2.5%	6.1%
Vajra, ujë dhe ujë mineral	14.0%	28.0%	29.1%	44.4%	21.2%	11.6%
Verëra, birrë, të tjera	18.0%	6.4%	24.5%	9.3%	7.0%	15.2%
Produkte të mishit	10.9%	6.5%	6.5%	4.6%	11.5%	8.2%
Të tjera (ushqim për kafshë, kafe, çaj, erëza)	10.4%	6.6%	19.1%	0.4%	8.5%	5.5%

Burimi: Anкета e UNDP, 2013


3.2. Prodhimet³

Gjetjet e anketës tregojnë se rreth 84% të kompanive prodhojnë produkte fundore, 18% prodhojnë produkte të ndërmjetme, ndërsa prodhimi i lëndës së parë është veprimtaria kryesore për vetëm 9% të kompanive.⁴

Bazuar në kategorizimin e Sistemit të Harmonizuar të Kodimit dhe Përshkrimit të Mallrave (SH)⁵ (Shtojca 4), rezultatet e anketës tregojnë se nënsektori i qumështorëve ka prodhimin më të lartë, vijuar nga prodhuesit e verës, birrës dhe vajrave, ujit dhe ujit mineral (Figura 6). Ndonëse prodhimi i biskotave dhe bukës përbën shumicën e kompanive që veprojnë në këtë sektor, për shkak të kapaciteteve të tyre të vogla të prodhimit, ky nënsektor ka nivelin më të ulët të raportuar të prodhimit. Përveç kësaj, katër sektorë: drithërat dhe gruri, pemët dhe perimet, mishi dhe të tjera (ushqimi për kafshë, kafeja, çaji dhe erëzat) kanë raportuar të njëjtën shkallë të prodhimit mesatar vjetor prej rreth €75,000.

85% Ofrojnë produkte fundore për shitës me shumicë/pakicë

Figura 6: Prodhimi vjetor mesatar sipas kategorisë së biznesit




Burimi: Anкета e UNDP, 2013

- 3 Për qëllime të këtij studimi, mbi 36 për qind të kompanive kanë refuzuar të përgjigjen në pyetjet që kanë të bëjnë me prodhimin e kompanive të tyre, prandaj është vështirë të nxjerrim përfundime për vlerën e prodhimit.
- 4 Gjetjet tregojnë se kompanitë që ofrojnë lëndë të parë gjithashtu ofrojnë produkte të ndërmjetme dhe fundore.
- 5 Sistemi i Harmonizuar i Përshkrimit dhe Kodimit të Artikujve, i njohur edhe si Sistemi i Harmonizuar (SH), apo nomenklatura e tarifave është sistem ndërkombëtar i standardizuar i emrave dhe numrave për kategorizimin e produkteve tregtare që hyri në fuqi më 1988, hartuar dhe mbajtur nga Organizata Botërore e Doganave (WCO).

3.3. Shfrytëzimi i kapacitetit

15% e kompanive të anketuara janë përgjigjur se kanë shfrytëzuar 100% të kapaciteteve të tyre të ekzistuese vitin e kaluar. Një krahasim i shfrytëzimit të raportuar të kapacitetit për vitet 2011 dhe 2012 tregon se përqindja e kompanive që shfrytëzojnë 75-100% të prodhimit të tyre është rritur nga 27.2% në 32.3%, përderisa përqindja e atyre që kanë shfrytëzuar ndërmjet 50 dhe 75% të kapaciteteve të tyre ka rënë nga 31.8% në 27.1%. Duhet të theksohet se përderisa 17.5% të kompanive kanë raportuar se kanë shfrytëzuar më pak se 25% të kapaciteteve të tyre më 2011, 15.4% kanë raportuar këtë nivel të shfrytëzimit të kapacitetit për 2012 (Figura 7).

Figura 7: Shfrytëzimi i kapacitetit të kompanive



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Niveli i raportuar i shfrytëzimit të kapacitetit ndryshon kur ndahen të dhënat sipas nënsektorëve. Për shembull, nënsektori i qumështoreve ka raportuar nivelin më të lartë të shfrytëzimit të kapacitetit, vijuar nga nënsektori i ujit, ujit mineral dhe vajrave. Për më tepër, ndryshimet në shfrytëzimin e kapacitetit janë të dukshme edhe tek madhësitë e ndryshme të kompanive, ku kompanitë e mesme dhe të mëdha kanë raportuar shfrytëzim më të ulët mesatar të kapacitetit (53%) siç është treguar në Tabelën 6 më poshtë.


Tabela 6: Pjesa mesatare e shfrytëzimit të kapacitetit në nënsektorë sipas madhësisë së kompanive

Përpjesa/përqindja mesatare e kapacitetit, shfrytëzuar në %			
	Mikro	Të vogla	Të mesme dhe të mëdha
Drithëra dhe grurë	53%	55%	50%
Pemë dhe perime	56%	50%	45%
Produkte të qumështit, akullore, çokollata	70%	70%	65%
Biskota dhe bukë	54%	52%	50%
Vajra, ujë dhe ujë mineral	65%	66%	63%
Verë, birra, të tjera	64%	60%	58
Produkte të mishit	59%	50%	45%
Të tjera (ushqim për kafshë, kafe, çaj, erëza)	57%	55%	45%
Total	60%	57%	53%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Për vitin 2012, kompanitë që prodhojnë produkte qumështi, akullore dhe çokolatë; vajra, ujë dhe ujë mineral; dhe verëra, birra dhe pije alkoolike kanë raportuar një vlerë të shtuar prej mbi €100,000 për secilën (Figura 8). Qumështoret kanë realizuar vlerën më të lartë të shtuar në pothuajse €700,000. Vlera e shtuar është llogaritur si dallimi ndërmjet kontributeve dhe prodhimit. Meqë prodhimet janë raportuar si intervale, në kalkulime janë përdorur pikat e mesit.


Figura 8: Vlera e shtuar



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Prodhimi dhe shpenzimet e përgjithshme operative që janë raportuar arrijnë mbi €61 milionë për tërë sektorin e përpunimit dhe paketimit të ushqimit. Ndarja e mëtejme e kësaj tregon se shpenzimet operacionale përbëjnë rreth €24 milion ndërsa shpenzimet e prodhimit deri €37 milionë. Për më tepër, të ardhurat totale vjetore arrijnë deri në €89 milionë për vit (Figura 9). Raporti i kalkuluar për vitin 2012 i intensitetit të kapitalit është vlerësuar të jetë në €1.42.⁶

Figura 9: Të ardhurat krahasuar me shpenzimet



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

⁶ Asetet totale të vlerësuara 2012 në vlerë prej €20,333,296 pjesëtuar me shitjet totale të vlerësuara për 2012 prej €14,270,000

4. Tregjet⁷, eksportet dhe pengesat për eksport

Për vitin 2011 dhe 2012, 25% të kompanive kanë deklaruar të hyra prej €25,000 në vit (Figura 10). Figura 10 jep më shumë hollësi, duke treguar kalkulimet e asaj se sa kompani përafërsisht përfaqësohen në secilën kategori të të hyrave. Janë 91 kompani të regjistruara si përpunues të produkteve të qumështit, akullores dhe çokollatës që i takojnë kategorisë së të hyrave prej €10,000 deri €25,000 në vit. Shumë kategori janë të shënuara më zero, që do të thotë se llogaritjet nuk kanë mbuluar asnjë kompani të pranishme në ato grupe të të hyrave, por të dhënat mund të mos jenë tërësisht të sakta. Numri i kompanive që kanë deklaruar të hyra prej mbi €50,000 është rritur për 4% në periudhën prej 2011 dhe 2012, nga 130 deri 136 kompani. Përpunimi i pemëve dhe perimeve është nënsektori me rritjen më të madhe.


Figura 10: Të hyrat sipas aktivitetit kryesor



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rezultatet e anketës tregojnë se mbi 84% të shitjeve të sektorit të përpunimit dhe paketimit të ushqimit janë vendore, gjersa vetëm pak mbi 15% janë ndërkombëtare. Bazuar në të dhënat e grumbulluara për dy vitet e kaluara, rezultatet e anketës në Figurën 11, zbulojnë se përqindja e shitjeve vendore dhe ndërkombëtare kanë mbetur gati të pandryshuara ndërmjet 2011 dhe 2012.

Figura 11: Shitjet vendore kundrejt atyre ndërkombëtare




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

7 Në përgjithësi, kompanitë e mëdha të përpunimit në bujqësi kanë qenë ndërmarrje shoqërore, me lëndë të parë të blerë nga bujq individualë apo të importuar. Bujqit individualë zakonisht kanë në pronësi toka në parcela të vogla – nën 1.5 hektarë – (MBPZHR, 2012) prandaj dhe ishte e vështirë të prodhohet në sasi të mëdha. Shumë kompani të reja janë shfaqur, por shumica e përpunuesve ende janë të vegjël dhe nuk e mbulojnë tërë kërkesën e tregut vendor.

Më shumë se tre çerekë (76%) të kompanive të anketuara kanë raportuar se i shesin produktet e tyre tek shitësit me pakicë, më shumë se gjysma e tyre (59%) kanë raportuar se produktet e tyre i shesin tek distributorët/shitësit me shumicë dhe 53% i shesin tek konsumatorët fundorë. Gati 16% të kompanive shesin tek kompanitë e tjera për përpunim të mëtejshëm. Të dhënat e anketës gjithashtu tregojnë se 20% të kompanive shesin ekskluzivisht tek konsumatorët fundorë.


Figura 12: Ndarja e shitjeve sipas kanaleve të shpërndarjes



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Sipas raportit të Komisionit Evropian “Tregtia e mallrave me Kosovën”, defici-ti tregtar në sektorin e bujqësisë së Kosovës ishte mbi €524 milionë në vitin 2013. Të dhënat nga Doganat e Kosovës (2012) tregojnë se shuma totale e eksporteve për pemë dhe perime ishte €10.1 milionë (35%),⁸ drithëra dhe grurë €9 milionë (31.4%); verë,⁹ birra dhe pije të tjera të fermentuara €6.2 milionë (21.5%), ndërsa eksportet e nënsektorëve të tjerë ishin €1.2 milionë (4.3%)(Figura 13).

Figura 13: Ndarja e eksporteve sipas nënsektorit



Burimi: Doganat e Kosovës, 2013

8 Gjithsej qarkullimi për pemë dhe perime ishte €119.6 milionë më 2012, që përbënte deri 2.5% të BPV. Bilanci tregtar më 2011 vlerësohet të ishte €17 milionë ku përpunuesit shfrytëzonin vetëm 50% të kapaciteteve të tyre. Prodhimin mesatar për perimet është 14 tonelata për hektar (MBPZHR, 2009) më ulët sesa prodhimin në Maqedoni, që ka prodhim prej 20 tonelata për hektar (Investo në Maqedoni, 2010). Prodhimet e pemëve për një hektar janë rreth 15 (MBPZHR, 2009) gjersa në Maqedoni kjo është dyfish më e lartë (Investo në Maqedoni, 2010). Krahasimi me Maqedoninë është tërhequr bazuar në ngjashmëritë e klimës, pozitës gjeografike si shtet pa dalje në det, madhësisë dhe popullatës.

9 Importet e verës janë rreth 412,355 litra, por vlera e këtyre importeve tejkalon €2 milionë për shkak të çmimit të lartë të importeve (Rinvest, 2010). Në Kosovë janë 17 kompani të licencuara të përpunimit me rreth 200 punonjës të rregullt dhe vlerësohet se janë 5,000 bujq të rrrushit që veprojnë në Rahovec. (NgaRahoveci.com, 2013).

Rubrika 2: Tregtia e lirë

- ✓ Kosova është anëtare e CEFTA, EU ATP
- ✓ Normë e përgjithshme e sheshtë prej 10% për importet dhe 0% për eksportet
- ✓ Kosova përfiton nga Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave me SHBA-në (që përfshin eksportet e shumë produkteve bujqësore pa tarifa doganore),
- ✓ Marrëveshje e tregtisë së lirë me Turqinë,
- ✓ Preferenca tregtare me Japoninë dhe Norvegjinë me disa kufizime.(CEFTA, 2013)

Rubrika 3: Procedurat e eksportit


Dokumentacioni i duhur për eksportin e ushqimit të përpunuar përfshin si në vijim:

- ✓ Dokumenti Unik Administrativ (SAD)
- ✓ Fatura
- ✓ Certifikata e prejardhjes apo €1.

Pika e fundit përfshin certifikim fitosanitar apo veterinar (nëse produkti është i mishit), duke përfshirë certifikim të standardeve HAACAP dhe ISO standard bazuar në llojin e produktit dhe tregun e synuar. Shumica e kritereve për eksport caktohen nga shteti importues.(Doganat e Kosovës, 2013)

Ndarja e industrisë sipas kodeve SH duke përdorur bazën e të dhënave të Doganave të Kosovës tregon se vetëm dy nënsektorë kanë pasur bilanc tregtar pozitiv më 2012: bimët dekorative dhe bimët mjekësore (për €5 milionë), dhe sektori i verërave (me €0.7 milion); ndërsa, sektori i mishit, qumështit dhe ai i pemëve dhe perimeve karakterizohen me një bilanc tregtar negativ, ku nënsektori i qumështit prin në listë me bilanc negativ prej €53 milionë (Figura 14).¹⁰ Sektori i mishit ka bilanc tregtar negativ prej €52 milionë. Rreth €20 milionë të këtij bilanci tregtar negativ përbëhen nga importet e mishit të përpunuar dhe pjesa tjetër është mish i freskët i gatshëm për përpunim. Nënsektorët e pemëve dhe perimeve kanë bilanc tregtar negativ prej €11 milionë euro, ku vajrat kanë bilanc negativ prej rreth €9 milion, dhe biskotat, buka, etj., minus €8 milionë.

Figura 14: Bilanci tregtar në sektor (në miliona €)




Burimi: Doganat e Kosovës, 2013

¹⁰ Sektori i përpunimit të mishit kontribuon me 5.2% të BPV ose rreth 243 milionë €. Pothuajse 90% e mishit të përpunuar është i importuar, ndërsa mishi i freskët, i ftohtë dhe i ngrirë vlerësohet të jetë € 50 milionë të importeve, dhe € 20 milionë të importeve të mishit të përpunuara (APIK, 2008). Përpunuesit aktualë shfrytëzojnë vetëm 20% të kapaciteteve të tyre (MBPZHR, 2009). Nuk ka eksporte të mishit për shkak të furnizimit të ulët. Degët aktuale të bagëtisë primare janë joadekuete ashtu që objektet, fermat e lopëve dhe deleve kombinohen për të prodhuar qumësht dhe mish. E njëjta prodhimin dhe përpunimin e pulave dhe vezëve).

Kur janë pyetur për arsytet për moseksportim, më shumë se gjysma e kompanive të anketuara kanë deklaruar se eksportet 'nuk janë pjesë të planit [të tyre] të biznesit,' ndërsa respondentët e mbetur janë të ndarë ndërmjet atyre që "synojnë të eksportojnë" por nuk janë të gatshëm dhe atyre që konsiderojnë se "ka shumë pengesa" në procesin e eksportit (Figura 15).

Figura 15: Arsyet për moseksportim



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Mesatarisht, shitjet e huaja si pjesë e shitjeve totale vlerësohen të kenë 15% për kompani. Mallrat dhe shërbimet tipike të eksportuara përfshijnë produktet fundore (rreth 80%), produktet e ndërmjetme (rreth 10%), dhe lënda e parë (30%). Blerësit e rëndomtë të këtyre produkteve janë distributorët dhe konsumatorët fundorë, ndërsa vetëm disa kompani eksportojnë mallra për përpunim të mëtejshëm apo drejtpërsëdrejti tek shitësit me pakicë. Kompanitë e anketuara kanë deklaruar se eksportet e tyre kanë qenë më të lartat më 2012, ku 16.7% të tyre eksportojnë. Bazuar në të dhënat e importit dhe eksportit, eksportet përbënin mbi €27 milionë më 2012, krahasuar me mbi €22 milionë më 2011. Sipas rezultateve të anketës, eksportet për ushqimet e përpunuara janë rritur për 50% për tri vitet e fundit (nga 2011 deri 2013). Tregjet kryesore të eksportit radhiten si në vijim:

49% rritje në eksportet

- ✓ Shqipëri
- ✓ Maqedoni
- ✓ Serbi
- ✓ Mal i Zi
- ✓ Kroaci
- ✓ Gjermani
- ✓ Itali
- ✓ Disa shtete të Lindjes së Mesme

Ndryshimet në eksportet totale të sektorit dhe eksportet mesatare të kompanive për periudhën 2010-2012 janë paraqitur më poshtë (Tabela 7). Në krahasim të shifrave të vitit 2010 me ato të 2012, shohim se eksportet totale të sektorit janë rritur për 27%, ndërsa eksportet mesatare të kompanive kanë përjetuar rritje prej 42%.

Tabela 7: Eksportet totale dhe mesatare

Viti	Totali në €	Mesatare në €
2010	21,721,964	193,946
2011	22,847,079	226,209
2012	27,607,510	275,680

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kur janë pyetur për pengesat kryesore për eksporte,¹¹ kompanitë kanë konsideruar se mungesa e financimit dhe marrëdhëniet politike me shtetet importuese janë pengesat kryesore (Tabela 8).

Tabela 8: Pengesat për eksportim

Pengesa:	Radhitja mesatare:
Mungesa e financimit	8
Marrëdhëniet politike me shtetin importues	8
Kosto e lartë e garancive bankare	6
Procedurat doganore	6
Mosefikasiteti i zyrtarëve doganorë	4
Mosefikasiteti i doganave të shtetit importues	3
Shpenzimet për transport	2
Kërkesa të larta për standardet ndërkombëtare të cilësisë	2
Mundësit të kufizuara për rrjetëzim	2
Infrastruktura e shtetit transit apo importues	2

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Përveç kësaj, respondentët konsiderojnë se atributet vijuese të brendshme të kompanisë janë pengesa për eksportet e tre (Tabela 9):

Tabela 9: Pengesat e brendshme për eksport

Pengesa:	Vlerësim:
Pamundësia për të ofruar trajnime për punonjësit	5
Mosefikasiteti i strukturës së menaxhimit	3
Mungesa e njohurive për vendosjen e produkteve	3
Mungesa e gatishmërisë së pronarit për t'u zgjeruar	2
Mungesa e njohurive për krijimin e marrëdhënieve me blerës të huaj	2
Pamundësia për të arritur certifikim ndërkombëtar	1

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

11 Shkalla e vlerësimit nga 0 – nuk është pengesë deri në 10 – pengesë e madhe

5. Punësimi, kapacitetet njerëzore dhe zhvillimi i fuqisë punëtore në kompani/industri


5.1. Punonjësit në industri

Llogaritjet bazuar në të dhënat e anketës tregojnë se më 2012, krahasuar me vitin 2011, numri total i punonjësve në sektor është rritur për 31%. Rreth 20% të kompanive të përpunimit dhe paketimit të ushqimit kanë deklaruar se kanë vetëm dy persona të punësuar, 14% kanë raportuar se kanë tre të punësuar dhe 13% kanë katër punonjës.

31% rritje në punësimin total

Më 2011, gratë përbënin 29% të të gjithë personave të punësuar në sektor dhe më 2012 ky numër ka rënë në 24% (Figura 16). Përveç kësaj, 6.4% të kompanive kanë deklaruar se nuk kanë të punësuar asnjë grua.

Figura 16: Ndarja e punonjësve të industrisë sipas gjinisë



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Të dhënat për llojet e punësimit gjithashtu zbulojnë skenarë tipikë të punësimit sipas madhësisë të kompanisë. Kompanitë mikro dhe të vogla punësojnë vetëm 10% të stafit të tyre me orar të plotë, ndërsa 90% e stafit është i punësuar në sezona. Kompanitë e mesme tregojnë se 40% të punonjësve të tyre janë të punësuar me orar të plotë, 10% me gjysmë orari, ndërsa 40% janë punëtorë sezonalë. Kompanitë e mëdha deklarojnë se 60% e punonjësve të tyre janë të punësuar me orar të plotë, 20% me gjysmë orari dhe 20% sezonalë. (Tabela 10).


Tabela 10: Skenari i punësimit mesatar të kompanive sipas madhësisë

Madhësia e kompanisë			
Punësimi	Mikro dhe të vogla	Të mesme	Të mëdha
Orar të plotë	10%	40%	60%
Gjysmë orari	0	10%	20%
Sezonal	90%	40%	20%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Për sa i përket ndarjes së punonjësve për nga struktura e moshës, të dhënat tregojnë se shumica e punonjësve janë të moshës ndërmjet 25 dhe 50 vjeç. Mbi 96% të kompanive deklarojnë se punësojnë njerëz të moshës 25 deri 50 vjeç, 62% të kompanive raportojnë se punësojnë të ri ndërmjet 18 dhe 25 vjeç, 23% të kompanive kanë raportuar se punësojnë individë më të vjetër se 50 vjeç (Figura 17).

Figura 17: Ndarja e punësimit sipas strukturës së moshës




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

5.2. Rritja e kompanive sipas numrit të punonjësve

Kompanitë kanë përjetuar rritje mesatare prej 50% nga viti 2010 në 2013, e cila ndryshon nga 30-50% varësisht nga nënsektori, që me gjasë është ndikuar nga numri i kompanive të reja të regjistruara në treg që nga viti 2010. Të dhënat për kodet SH tregojnë që nënsektori i pemëve dhe perimeve ka përjetuar rritjen më të madhe gjatë kësaj periudhe për sa i përket numrit të punonjësve (Figura 18).

Figura 18: Rritja e kompanive sipas numrit të punonjësve




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

5.3. Paga mesatare dhe niveli i arsimit të punonjësve

Rezultatet e anketës tregojnë se paga mesatare mujore në sektor është €290 që tregon një rënie prej 5.2% nga biti 2010 (Riinvest, 2010). Anketa tregon që pagat ndryshojnë nga €200 deri €400, ndërsa pagat e grave të angazhuara në sezon janë më të ulëta se €200. Por, për kompanitë që kanë punonjës më të arsimuar, paga mesatare rritej deri në mbi €500 në muaj për punonjësit burra dhe gra.

Ekziston një barazi për sa i përket arritjeve arsimore të burrave dhe grave punonjës në këtë sektor (Figura 19). 35% e grave kanë kryer shkollimin fillor, 55% e tyre shkollën e mesme, ndërsa 11% kanë nivele të tjera të shkollimit. Niveli arsimor i burrave është si vijon: 20% kanë përfunduar shkollën fillore, 65% shkollën e mesme dhe vetëm 10% kanë kryer shkollim të lartë.


Figura 19: Ndarja e nivelit arsimor sipas gjinisë



Të dhënat e anketës tregojnë se kompanitë më të mëdha punësojnë një numër më të lartë të personave me arsim të lartë, si dhe ofrojnë më shumë në trajnime të brendshme për punonjësit e tyre në krahasim me kompanitë e madhësive të tjera. Kompanitë ofrojnë më shumë trajnime për burra sesa për gra. Rreth 55% të grave pranojnë trajnime, krahasuar me 86% të burrave (Figura 21). Kompanitë që mbajnë trajnime praktike, 44% të tyre i japin për burra, ndërsa vetëm 25% për gratë. Një mospërputhje gjinore është e dukshme edhe në ofrimin e trajnimeve menaxheriale, aftësive të prezantimit dhe të menaxhimit të kohës, si dhe 25% e tyre janë ofruar për burra, 15% për gra. Pabarazia gjinore është më pak e dukshme për punëtoritë e organizuara: 17% të kompanive kanë raportuar se ato janë ofruar për burrat, ndërsa 15% për gratë (Figura 20).

Më pak trajnime menaxheriale ofrohen për gra sesa për burra

Figura 20: Ndarja e trajnimeve të ofruara sipas gjinisë



Për sa i përket arsimimit pas shkollës së mesme për profesionet sektoriale, Universiteti i Prishtinës ofron specializime në bujqësi, agro-ekonomi, mbrojtje të bimëve, studim të pemishteve dhe perimeve dhe studim të frutave dhe vreshtarisë. Numri mesatar i studentëve të regjistruar është 90 në vit, me 50-70 të diplomuar në vit. Fatkeqësisht, nuk ka program të veçantë për përpunimin dhe/ose paketimin e ushqimit. Pavarësisht disponueshmërisë së programeve të mësipërme, rezultatet e anketës sugjerojnë se 35% e kompanive besojnë se ekziston një mungesë e konsiderueshme e punonjësve të kualifikuar në sektori; megjithatë, 35% besojnë se kjo është disi e vërtetë.

Më shumë se gjysma e kompanive të intervistuar besojnë ose disi besojnë se punonjësit e kualifikuar janë të shtrenjtë dhe se të diplomuarit e përshtatshëm për industrinë mungojnë. Përveç kësaj, të intervistuarit mendojnë se operatorët e makinerisë, profesionistët në fushën e bujqësisë dhe teknologët e ushqimit (më saktësisht “teknologë të përpunimit të mishit”) janë tri profesionet më deficitare në industri ndonëse janë shumë të kërkuar dhe të rëndësishëm.

Punonjësit e kualifikuar janë shumë të shtrenjtë


Rubrika 4: Rregulloret e punës

Kosova ka një treg fleksibil të punës me normë të ulët tatimore dhe kufizime të pakta në punësimin e punonjësve. Sistemi i normës së tatimit në të ardhura personale është sistemi progresiv tatimor me normë prej 0-10 %. Përveç kësaj, vetëm një kontribut pensional prej 5% nga paga e plotë paguhet nga punëdhënësi (gjersa 5% të tjera nga paga e punonjësit). Që nga viti 2011, Kosova ka aplikuar një pagë minimale prej €170, apo €130 për individët nën moshën 35 vjeçe. Që nga viti 2011, marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me ligjin e punës (nr. 03/L-212) i cili merr parasysh Konventat e ONP, legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut të lirë dhe ekonomisë së lirë. Që nga viti 2013, shëndeti dhe siguria në punë rregullohen me ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë (nr. 04/L-161).

6. Investimet në kompani/industri dhe niveli teknologjik

Shumica e kompanive që veprojnë në sektorin e përpunimit dhe paketimit të ushqimit kanë deklaruar se kanë në pronësi shumicën e aseteve (Figura 21). Rreth 60% kanë raportuar se kanë në pronësi tokë, 63.4% posedojnë ndërtesa, dhe 75.9% makineri. Kompanitë mikro kanë raportuar se vlera e teknologjisë së tyre është rritur për 15% nga viti 2011 në 2012, gjersa vlera e teknologjisë së kompanive të vogla është rritur për 40%, duke i bërë këto të fundit më konkurrentë në treg.

Figura 21: Vlera e aseteve sipas madhësisë së biznesit



Për më tepër, rezultatet tregojnë se rritja e konsiderueshme në vlerën e aseteve ka ndodhur gjatë vitit 2012. Ndërmjet vitit 2011 dhe 2012, vlera e përafërt e kombinuar e makinerisë, ndërtesave dhe pajisjeve është rritur për 40% gjersa vlera e tokës ka mbetur e pandryshuar. Mesatarisht, kompanitë kanë deklaruar një vlerë të përafërt prej €50,000 për tokën e tyre më 2011 dhe 2012. Në vitin 2012, vlera e ndërtesave është vlerësuar të jetë €50,000, krahasuar me vetëm €20,000 më 2011. Vlera mesatare e makinerisë është vlerësuar të jetë €15,000 më 2012.

Tabela 11 tregon se vetëm 20% të kompanive kanë deklaruar se kanë investuar në zhvillimin e produkteve të reja (€10,000 mesatarisht) më 2012, me 10% (€9.4 milionë) që vinin nga remitancat nga Diaspora. Rreth 20% të kompanive kanë investuar në etiketim dhe paketim, si dhe procedura për certifikim dhe dokumentim të përgjithshëm. (d.m.th. përgatitje të planeve të biznesit, marka tregtare, certifikime të standardeve ISO, certifikim HACCP dhe analiza të produkteve nga Instituti Bujqësor në Pejë). Shuma mesatare e investuar për këtë qëllim është raportuar të jetë €10,000.

Tabela 11: Vlera e përafërt e investimeve në produkte

Lloji i investimit	Vlera mesatare	% mesatare e gjithsej investimit në produkt
Avancimi i produktit	€10,000	20%
Makineri	€10,000	20%
Marketing dhe promovim	€10,000	20%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Për sa i përket hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit, më 2012, rreth 20% të të gjitha kompanive kanë deklaruar se kanë investuar në përmirësimin e metodave të prodhimit apo avancimin e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit dhe marketing, siç është treguar në pjesën e mëparshme. Kompanitë e mëdha kanë raportuar se kanë investuar mesatarisht 60% të fondeve të tyre totale për investime në makineri, 20% në avancim të produkteve, dhe 20% në marketing dhe promovim. Kompanitë që kanë investuar në etiketim kanë pohuar se investimet e tyre kryesisht janë fokusuar në shpenzimet e printimit dhe më pak në dizajn të etiketës.

Rubrika 5: Prona industriale dhe patentat

Tetëdhjetë e gjashtë përqind të kompanive të anketuara kanë raportuar se kanë patentë të regjistruar në Kosovë. Rritja ka ndodhur në regjistrimet e patentave gjatë vitit 2000 kur departamenti rinisi funksionimin në Kosovë. Një pjesë e vogël e bizneseve (15 %) beson se procesi i regjistrimit të patentës pengon zhvillimin e biznesit të tyre. Por, kjo nuk ka të bëjë me zhvillimin e biznesit vendor por paraqet pengesë kryesisht për kompanitë bizneset e të cilave varen nga eksportet, dhe problemi kryesor është thënë të jetë kohëzgjatja e procesit. Megjithatë, problemet në funksionimin e vërtetë të biznesit të tyre nuk ekzistojnë, meqë agjencia e patentimit ofron dokumente të përkohshme në pritje të regjistrimit përfundimtar të markës/patentës. Megjithatë, kur bëhet fjalë për eksportimin e produkteve, ky proces mund të shkaktojë probleme meqë dokumentet e përkohshme nuk pranohen nga kompanitë e shtetit importues. Analizat e mëtejme të të dhënave tregojnë se nga 15% e bizneseve që besojnë se prona industriale dhe patentat janë pengesa për biznesin e tyre, është lehtë të konkludohet se ekziston një keqkuptim i zakonshëm lidhur me atë se çfarë është patenta dhe çfarë është prona industriale. 55% e të intervistuarve kanë deklaruar se “nuk ka vend për patentim të produkteve”, “Unë nuk e di ku të patentoj produktet e mia”, dhe “unë nuk kualifikohen për çështje të tillë”.


7. Mjedisi i biznesit

7.1. Perceptimet për pengesat për zhvillimin e biznesit

Të dhënat e anketës janë përdorur për t'i kalkuluar pengesat kryesore të mjedisit të biznesit duke përdorur vlerësimet nga 0 deri 10; 0 identifikon një element që nuk është pengesë, ndërsa 10 që është pengesë e madhe. Respondentët në anketë i kanë vlerësuar pengesat vijuese në mjedisin e biznesit si kryesoret për ta për bërje të biznesit: (1) mungesa dhe kosto e lartë e energjisë elektrike, (2) shkalla e lartë e tatimeve, (3) qasja në kredi, (4) korrupsioni, (5) mungesa e fuqisë blerëse në tregjet vendore, (6) mosefikasiteti i administratës tatimore në Kosovë dhe (7) mosefikasiteti i gjykatave.

Mungesa e punonjësve të shkathët, mungesa e të diplomuarve të specializuar, si dhe kostot e larta të punonjësve të kualifikuar janë tri pengesat më të mëdha. Shumica e këtyre kompanive kanë raportuar se sektori ka mungesë të operatorëve të makinerisë dhe teknologëve të ushqimit, gjersa pohojnë se profesionistët në fushën e konsulencës së bujqësisë duket të jetë më e shtrenjta.

Figura 22: Pengesat në bërje të biznesit



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Subvencionet përgjithësisht ofrohen përmes pagesave direkte, granteve investuese, dhe investimeve kapitale. Më 2012, €3 milionë subvencione enkas për përpunimin e ushqimit (pa paketim) janë ndarë nga MBPZHR, që ka rezultuar me investime prej €5.1 milionë nga bizneset në sektor. Numri i kompanive të mbështetura ka arritur 33 në nënsektorët e qumështit, mishit dhe pemëve e perimeve.

Sipas Komisionit Evropian, që nga viti 1999 në Kosovë në këtë sektor janë shpenzuar rreth €3 miliardë. Megjithatë, vetëm një pjesë shumë e vogël e këtyre fondeve (4% apo afro €120 milionë) janë synuar për sektorin e përpunimit dhe paketimit të ushqimit. Organizatat e donatorëve në vijim kanë mbështetur zhvillimin e bujqësisë në Kosovë: Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Zyra Austriake për Zhvillim dhe Bashkëpunim (ADC), Deutsche Gesellschaft für International Zusammenarbeit (GIZ), Komisioni Evropian (KE), Agjencia Suedeze për Zhvillim


dhe Bashkëpunim (SIDA), Zyra e Luksemburgut për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Lux-Dev), Shoqëria e Mbretërisë Norvegjeze për Zhvillim (NorgesVel).

Norma e tatimit në vlerë të shtuar (TVSH) në Kosovë është 16%; TVSH është 0% për inputet për prodhim bujqësor. Që nga shtatori 2013, qeveria ka aplikuar një tatim të normës së sheshtë prej 16% për produktet bujqësore shtesë, që aplikohet me kërkesë zyrtare të pronarit të agrobiznesit. Tatimet paguhen para datës 15 të çdo muaji dhe deri më 1 prill për deklaratat vjetore. Lista në vijim përfshin përfshin tatimet tjera relevante për sektorin:

- ✓ 0%TVSH në eksporte
- ✓ 10% tarifë në importet e përgjithshme; 0% në importet e produkteve kapitale dhe të ndërmjetme
- ✓ Tatimi në të ardhura ndryshon: tatim i thjeshtësuar në fitim në të ardhura fikse apo me përqindje
- ✓ Tatimi në të ardhura të korporatës dhe regjistrim për TVSH për qarkullim mbi €50,000

Rezultatet e anketës tregojnë se 51.5% të bizneseve mendojnë se niveli i tatimeve është i lartë dhe shumë i lartë. 42% mendojnë se niveli i tatimeve është mesatar, ndërsa 7% besojnë se niveli i tatimeve është i ulët dhe shumë i ulët. Figura 23 e paraqet këtë perceptim për tatimet dhe tarifat doganore për industrinë.


Figura 23: Perceptimet e biznesit për nivelin e tatimeve



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rreth 57% të respondentëve e kanë vlerësuar performancën e Administratës Tatimore si "mesatare" (Figura 24), ndërsa 19.1% e shohin performancën e saj si joefikase, gjersa 4.3% të tyre e shohin atë si tejet joefikase. 29.8% e kompanive mendojnë se performanca e ATK-së është efikase dhe tejet efikase.


Figura 24: Perceptimet e bizneseve për Administratën Tatimore



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Për sa i përket performancës së Doganave të Kosovës, gjysma e respondentëve e kanë vlerësuar performancën e tyre si mesatare (Figura 25). Mbi 20% të respondentëve e perceptojnë performancën e Administratës së Doganave si efikase, 4.5% si tejet efikase, ndërsa pjesa e atyre që e konsiderojnë atë si joefikase apo tejet joefikase është 17.3% dhe 6.4%, përkatësisht.

Figura 25: Perceptimi i bizneseve për Doganat




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Sipas studimit të Financimit për agrobiznese të Institutit Riinvest, normat e kamatës të institucioneve mikrofinanciare janë, së paku, 18% me kufizim të sipërm prej 27% (Riinvest, 2012).¹² Ky raport gjithashtu thekson se bankat komerciale lëshojnë më pak se 4% të kredive për agrobiznese, dhe se 69% të agrobizneseve nuk janë stimuluar për të aplikuar për agro-kredi. Në buletin e statistikave mujore të tetorit 2013, Banka Qendrore e Kosovës ka raportuar se norma mesatare efektive e kamatës në kredi të reja është 11.72%.¹³

“Ekziston një nevojë urgjente e huamarrësve për kredi specifike për agrobiznese, siç janë agro-kreditë afatgjate dhe agro-kreditë me grejs periodha të përshtatura enkas” (Riinvest, 2012). Nga bankat ekzistuese komerciale në Kosovë, vetëm pesë prej tyre ofrojnë agro-kredi. Sipas Bankës Qendrore në Kosovë, më 2011, kreditë e lëshuara për qëllime bujqësore kanë arritur rreth €427 milionë me shuma maksimale nga €100,000 deri €300,000.¹⁴

Figura 26 tregon se 59% e bizneseve të anketuara besojnë se normat e kamatës janë të larta apo tejet të larta. 36.7% të tjera besojnë se kostoja e financimit është mesatare, dhe vetëm 4.3% mendojnë se kosto e financimit është e ulët.

Figura 26: Perceptimi i bizneseve për koston e financimit



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

¹² Institutit Riinvest, studimi për financim në agrobiznese është financuar nga SDC më 2012.

¹³ Banka Qendrore në Kosovë. “Buletini i Statistikave Mujore (Nr. 146)”, tetor 2013.

¹⁴ Disa kompani të përpunimit të ushqimit kanë kredi të përgjithshme të biznesit në vend të agro-kredive. Bankat japin shuma maksimale për agro-kredi prej €100,000, gjersa përpunuesit e ushqimit theksojnë se kanë arritur të marrin kredi deri në €300,000. (Riinvest, 2012)

Rubrika 6: Lista e licencave dhe lejeve të nevojshme

- ✓ Xhirollogaria e kompanisë
- ✓ Certifikata e Biznesit dhe Informatat e Biznesit në ARBK
- ✓ Numri fiskal dhe Regjistrimi për TVSH
- ✓ Vula e kompanisë
- ✓ Inspektimi sanitar, i sigurisë dhe objektit
- ✓ ATK (Administrata Tatimore e Kosovës) inspektim i biznesit
- ✓ Regjistrimi i punonjësve për skemë pensionale
- ✓ Certifikimi sanitar – për qëllime të eksportit dhe importit paraqiten në kontroll kufitar
- ✓ Certifikimi i fitosanitarisë – Gjenda e brendshme e inspektimit për të gjithë sektorët e përpunimit të ushqimit që lidhen me dezinfektimin dhe/apo trajtimin
- ✓ Certifikimi veterinar – për eksport dhe import të produkteve të mishit

Rubrika 7: Ligjet dhe zbatimi i tyre

Legjislacioni specifik për ushqimin dhe produktet ushqimore janë Ligji nr. 03/L-016 specifik për këtë nënsektor, dhe përfshin.

- ✓ Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve
- ✓ Përkufizimin e ushqimit sipas përbërësve të lejuar
- ✓ Kontrollin e importeve
- ✓ Vendosjen e përgjithshme të ushqimeve në tregje
- ✓ Kontrolli zyrtar sistematik i ushqimit
- ✓ Menaxhimi i krizave
- ✓ Laboratorët testues
- ✓ Kërkesa të tjera të përgjithshme të operatorëve të biznesit të ushqimit

8. Konkluzion

Qëllimi i këtij raporti ishte që të ofrojë një profil të industrisë së përpunimit dhe paketimit të ushqimit në Kosovë.

Në vijim janë paraqitur disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti:

Gjithsej 7% të të gjitha kompanive në Kosovë i takojnë sektorit të përpunimit dhe paketimit të ushqimit, ku 89% të tyre janë kompani mikro dhe të vogla. Shumica e kompanive të anketuara janë me vendndodhje në afërsi të: Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës. 68% të kompanive të regjistruara prodhojnë produkte furre. Të dhënat e ARBK-së tregojnë se në përgjithësi ka pasur një rritje prej 50% në regjistrimin e kompanive të reja në periudhën 2010-2012.

Sipas kompanive të anketuara, rreth 84% të shpenzimeve mujore të kompanive të përpunimit dhe paketimit të ushqimit janë për blerjen e lëndës së parë. Ndërmarrjet mikro kanë raportuar të kenë shpenzuar mesatarisht mbi €25,000 në kontribute në muaj, shumica të importuara nga Maqedonia, Serbia dhe Turqia. Nënsektorët kryesorë, në kuptim të prodhimit të raportuar janë qumështoret (mesatarisht €68,000 për muaj) dhe verërat (mesatarisht €42,000 për muaj). Vlera e shtuar e këtyre nënsektorëve dhe ajo e kompanive që prodhojnë vajra është nën €10,000 mesatarisht për muaj për sektorin.

Produktet kryesore vendore të përpunuara që shiten brenda vendit janë produktet e qumështit, mishi, mielli, vajrat, dhe pemët dhe perimet, ku këto të fundit kanë përjetuar rritjen më të madhe në shitje ndërmjet 2011 dhe 2012. Të dhënat e doganave për tri vitet e kaluara tregojnë se bilanci tregtar është pozitiv vetëm për nënsektorët e verërave dhe bimëve, ndërsa eksportet janë në rritje si pasojë e 370 akterëve të ri në treg gjatë vitit 2013. Pesëmbëdhjetë për qind të të gjitha produkteve janë të destinuara për eksport në Shqipëri, Maqedoni dhe shtetet tjera të BE-së.

Për sa i përket aseteve, teknologjisë dhe investimeve, sipas anketës, vlera e tyre është rritur për 40% në periudhën 2011 dhe 2012. Më 2011, vlera e kombinuar mesatare është vlerësuar të jetë €85,000, gjersa më 2012 kjo është rritur në €115,000. Mesatarisht, shpenzimet e përgjithshme të prodhimit dhe ato operacionale për vitin 2011 deri 2012 janë vlerësuar të jenë €61 milionë, me qarkullim totale prej €89.6 milionë.

Bazuar në llogaritje të të dhënave të anketës, sektori i përpunimit dhe paketimit të ushqimit shpenzon rreth €5.5 milionë në paga në vit, ku 63% të punonjësve i takojnë kategorisë 18-25 vjeç. Numri total i punonjësve më 2012 ishte 13,500, ku gratë përbëjnë 25% të të gjithë punonjësve.

9. Referencat

Banka Qendrore e Kosovës, Buletini i Statistikave Mujore, tetor 2013

Komisioni Evropian 2008. Konferenca e Donatorëve e Komisionit Evropian, Belgjikë. KOMISIONI EVROPIAN, Bruksel, 2008. <http://ec.europa.eu/enlargement/archives/seerecon/kdc/prospectus.pdf>

ECIKS, IPAK, 2008. Industria e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit. MTI, qershor 2008.

<http://www.eciks.org/english/publications/agriculture-kosovo.pdf>

Index Kosova2013. Përpunimi i ushqimit Anketë e sektorit 2013. Prishtina, UNDP, tetor 2013.

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë 2013. Lista bizneseve të regjistruara. Prishtinë ARBK nëntor 2013.

Ramana R. Govin, Edvin Kotherja 2010. Industria e përpunimit dhe potenciali i saj në sektorin e hortikulturës në Kosovë HELVETAS SWISS INTERCOOPERATION. Prishtinë, prill 2009. http://www.helvetask.org/HPK/documentation/technical_reports/Govin%20R.,%20Kotherja%20E.,%20Processing%20industry%20and%20its%20potential%20in%20the%20horticultural%20sector%20in%20Kosovo,%20HPK,%20Prishtina,27%20pp.pdf

Administrata Tatimore e Kosovës 2013. Lista e bizneseve që paguajnë tatime. Prishtinë, ATK, tetor 2013.

MBPZHR 2009. Bujqësia dhe Plani i Zhvillimit Rural 2010-2013. Prishtinë, MBPZHR, maj 2009.

http://www.mbpzhr-ks.net/documents/743026_Agriculture_and_Rural_Development_Plan_2009-13.pdf

MBPZHR 2012. Programi i Granteve Investuese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Prishtinë, MBPZHR mars

2012. Instituti Riinvest 2009. Strategjia e industrive, Prishtinë. MIT, mars, 2009. http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_Industrise_se_Kosoves_2009-2013_SHQ.pdf

USAID 2010. Plani Strategjik i Kosovës - USAID. Prishtinë, USAID, maj 2010

http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PDACQ298.pdf

USAID Kosovë 2011. Programi - Mundësi të reja për bujqësi në Kosovë (NOA) –Tregu i ri rajonal

Vlerësim. Prishtinë, TETRATECH, tetor 2011.

<http://noakos.com/wp-content/uploads/2013/03/Regional-Marketing-Assessments-Report-December-2011-English-only.pdf>

Shtojcat

Shtojca 1: Informata për institucionet publike relevante

Disa institucione janë të rëndësishme për sektorin e bujqësisë, duke përfshirë industrinë e përpunimit dhe paketimit të ushqimit:

- ✓ Për testimin dhe verifikimin e produkteve, përpunuesit e ushqimit mund t'i adresojnë kërkesat e tyre në Institutin e Bujqësisë në Pejë, që është pjesë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). MBPZHR përbëhet nga 10 departamente të nënsektorëve të veçantë dhe dy agjenci: Departamenti i Pylltarisë dhe Departamenti i Zhvillimit të Bujqësisë. Këto departamente dhe agjenci janë të hapura për bizneset për trajtimin e pyetjeve të tyre të përgjithshme. Një departament i rëndësishëm është ai i Politikave Industriale, përgjegjës për hartimin e politikave në sektorin e MTI-së.
- ✓ Për markat tregtare të produkteve, patentat dhe regjistrimin e emrit të brendit, përpunuesit e ushqimit mund të aplikojnë në Departamentin e Patentave dhe Markave Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI).
- ✓ Për aplikim për grante dhe subvencione në nivel lokal, dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore, përpunuesit e ushqimit mund të konsultohen me zyrën komunale për bujqësi në komunën e tyre përkatëse.
- ✓ Për regjistrimin e bizneseve të reja, numri fiskal, dhe dokumente të regjistrimit të biznesit, përpunuesit e ushqimit mund të aplikojnë tek Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).
- ✓ Për regjistrim tatimor, marrje të certifikatës së TVSH-së dhe regjistrim të punonjësve, përpunuesit mund të aplikojnë tek Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).
- ✓ Për kodin e doganave dhe akcizave, përpunuesit e ushqimit mund t'i parashirojnë kërkesat e tyre në Doganat e Kosovës që gjenden në Prishtinë.
- ✓ Për lëshim të barkodeve, certifikatave të prejardhjes, shërbime të arbirimit, rrjetëzimit, lobim, trajnime, promovim dhe konsulentë, përpunuesit mund të regjistrohen për t'u bërë anëtarë të Odës Ekonomike të Kosovës.

Shtojca 2: Shoqatat e biznesit të industrisë

Shoqatat private në industrinë e bujqësisë në Kosovë janë shumë të rëndësishme për sektorin e përpunimit dhe paketimit të ushqimit dhe ato bazohen në grupacione specie për nënsektorë të kompanive që kanë interesa të përbashkëta, si:

- ✓ Shoqata e bimëve mjekësore,
- ✓ Unioni i bletarëve të Kosovës,
- ✓ Shoqata e prodhuesve të produkteve të qumështit të dhisë,
- ✓ Shoqata e përpunuesve të grurit, hirrës dhe drithërave,
- ✓ "Enologjia" për vreshtaritë dhe kantinat e verës,
- ✓ Unioni i Pemëve në Kosovë,
- ✓ Shoqata e përpunuesve të qumështit,
- ✓ Shoqata e rrjetit të grave në Kosovë, dhe
- ✓ Unioni i ushqimit të kafshëve.

Anëtarësitë në këto shoqata bëhen përmes aplikimeve direkte dhe pagesës së tarifës vjetore. Shoqatat e përpunuesve, si dhe të gjitha shoqatat tjera të sipërpërmendura, tani janë të bashkuara në kuadër të Unionit të Shoqatave Bujqësore të Kosovës që nga prilli 2013.

Shtojca 3: Kodet e veprimtarisë

- 01.64 Përpunimi i farërave
- 10.11 Përpunimi i mishit
- 10.12 Përpunimi i shpezëve
- 13.10 Prodhimi i mishit dhe mishit të shpezëve
- 10.20 Përpunimi i produkteve të mishit (të gjitha)
- 31.10 Përpunimi i patates
- 10.32 Prodhimi i lëngjeve të pemëve dhe perimeve
- 10.39 Përpunimet tjera dhe konservimi i pemëve dhe perimeve
- 10.41 Prodhimi i vajrave dhe yndyrave
- 10.42 Prodhimi i gjalpët dhe yndyrave
- 10.51 Përgatitja e produkteve të qumështit dhe djathërave
- 10.52 Prodhimi i akullores
- 10.61 Prodhimi i drithit të mullirit
- 10.62 Prodhimi i niseshtesë dhe produkteve të saj
- 10.71 Prodhimi i bukës, kifëve dhe ëmbëlsirave
- 10.72 Prodhimi i biskotave galetave të shkurtra
- 10.73 Prodhimi i makaronave, laminave, kuskusit dhe produkteve të ngjashme nga mielli
- 10.81 Prodhimi i sheqerit
- 10.82 Prodhimi i kakaos, çokollatave dhe ëmbëlsirave
- 10.83 Përpunimi i çajit dhe kafesë
- 10.83 Përpunimi i çajit dhe kafesë
- 10.84 Prodhimi i erëzave dhe salcave
- 10.85 Prodhimi i ushqimeve dhe shujtave të gatshme
- 10.86 Prodhimi i ushqimit të homogjenizuar dhe dietar
- 10.89 Prodhimi i produkteve të tjera të ushqimit
- 10.91 Prodhimi i ushqimit të përgatitur për kafshë bujqësore
- 10.92 Prodhimi i ushqimeve të përgatitura për kafshë shtëpiake
- 1.11 Distilimi, riciklimi dhe përzjerja e alkoolit
- 11.02 Prodhimi i verës nga rrushi
- 3.11 Prodhimi i verës së mollës dhe verërave të tjera të pemëve
- 11.04 Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padistiluara
- 11.05 Prodhimi i birrës
- 6.11 Prodhimi i maltit
- 11.07 Prodhimi i pijeve të buta; prodhimi i ujit mineral dhe ujit në shishe
- 12.00 Prodhimi i produkteve të duhanit

Shtojca 4: Kodet e SH

16ED. PËRGATITJA E MISHIT, PESHKUT, KRUSTACEVE, ETJ.

- 1601 salsiçe, produkte të ngjashme të mishit etj përgatitja e tyre
- 1602 përgatitja e mishit të konservuar, mishit të gjedhes
- 1603 ekstrakte etj. të mishit, peshkut, krustaceve, etj.
- 1604 përgatitja apo shtypja e peshkut, kaviarit & dhe zëvendësimeve për kaviar
- 1605 krustace, molusqe, etj., të përgatitur apo të konservuara

17 SHEQERET DHE ËMBËLTORET

- 1701 kallam apo panxhar sheqeri dhe sukrozë e pastër, formë të ngurtë
- 1702 sheqer, laktozë inçhem etj, karamel
- 1703 melasë nga nxjerrja apo rafinimi i sheqerit
- 1704 ëmbëlsirat (përfshirë çokollatë të bardhë), pa kakao

18KAKAO & PËRGATITJA E KAKAOS

- 1801 kokra të kakaos, të tëra apo të thyera, të papërpunuara apo të pjekura
- 1802 guaza të kakaos, lëvore, lëkura dhe mbetje të tjera
- 1803 kakao pastë
- 1804 kakao gjalpë, yndyrë dhe vaj
- 1805 kakao pudër, e pa ëmbëlsuar
- 1806 çokollatë & dhe produkte tjera me kakao

19 PËRGATITJA E DRITHËRAVE, MIELLIT, NISESHTESË APO QUMËSHTIT

- 1901 nxjerrja e maltit, përgatitja e ushqimit të miellit, etj nën 50% kakao etj
- 1902 pasta, përgatitur apo jo, kuskus, përgatitur apo jo
- 1903 tapioca dhe zëvendësime nga niseshteja, etj
- 1904 ushqimet nga drithërat, cereal nesoi,
- 1905 bukë, brumëra, etj: wafers, kupat boshe etj

20 PËRGATITJA E PERIMEVE, PEMËVE, ARRAVE, ETJ.

- 2001 perime, pemë, arra, etj, përgatitja apo shtypja me uthull etj.
- 2002 domate të përgatitura apo të konservuara nesoi
- 2003 kërpudha dhe zhardhok të përgatitur apo të konservuar nesoi
- 2004 perime nesoi të përgatitura apo të konservuara nesoi, të ngrira
- 2005 perime nesoi të përgatitura etj nesoi, jo të ngrira
- 2006 pemë/arra/pemë etj, të konservuara me sheqer
- 2007 reçeje, marmelata të pemëve, etj, të ziera
- 2008 pemë, arra etj të përgatitura apo të konservuara nesoi
- 2009 lëngje pemësh (& rrush) & lëng perimesh, pa alkool

21 PËRGATITJE TË NDRYSHME USHQIMORE

- 2101 ekstrakte të kafesë, çajit, rosto çikore
- 2102 majë, dead sing-cell micro-org nesoi, pluhur pjekje
- 2103 salca mëlmesa të përziara, mustardë etj
- 2104 supa, çorba & ushqime të homogjenizuara
- 2105 akullore dhe akuj të tjerë ushqimor me apo pa kakao
- 2106 përgatitja e ushqimit nesoi

22 PIJE, ALKOOL DHE UTHULL

- 2201 ujë, natyral etj, i paëmbëlsuar etj, akull & borë
- 2202 ujë, i ëmbëlsuar etj & pije tjera joalkoolike nesoi
- 2203 birra nga malti
- 2204 verë nga rrush i freskët, rrush nesoi
- 2205 vermut & dhe verëra të tjera të rrushit me shije të veçanta
- 2206 pije të fermentuara nesoi
- 2207 etil alkool
- 2208 etil alkool, nën 80% alkool
- 2209 uthull dhe përbërësit e uthullës

23 MBETJET NGA INDUSTRI TË USHQIMIT, USHQIM PËR KAFSHË

- 2301 miell, shujta etj nga mishi etj, jo për njerëz
- 2302 krunde, sharps etj nga puna me drithëra & bimë
- 2303 mbetjet e niseshtesë mfr apo sheqerit mfr apo përgatitjes etj
- 2304 bërsi për kafshë nga soja & dhe mbetje tjera të ngurta,
- 2305 bërsi për kafshë nga badiava & mbetje tjera të ngurta,
- 2306 bërsi për kafshë etj nesoi, nga yndyra të perimeve & vajra nesoi
- 2307 fundërrina të verës, argol
- 2308 materialet e perimeve, mbetjet etj për ushqimet për kafshë nesoi
- 2309 përgatitjet që përdoren në ushqimin e kafshëve

24 DUHAN & PRODHIM I ZËVENDËSIMEVE PËR DUHAN

- 2401 duhan, i pa prodhuar, duhan refuz
- 2402 cigare, puro etj., duhan apo zëvendësim
- 2403 duhan & substanca duhani, etj





MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

www.mti-ks.org